



## “Kur të vijë Ramazani, hapen portat e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur të vijë Ramazani, hapen portat e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe prangosen shejtanët.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ ka njoftuar se, kur vjen muaji i Ramazanit, ndodhin tri gjëra: E para: Hapen dyert e Xhenetit dhe asnjëra prej tyre nuk mbyllet. E dyta: Mbyllen dyert e Xhehenemit dhe asnjëra prej tyre nuk hapet. E treta: Shejtanët dhe xhindët kryeneçë lidhen, kështu që nuk arrijnë të bëjnë atë që zakonisht bëjnë jashtë Ramazanit. E gjithë kjo bëhet për ta nderuar këtë muaj dhe për t'i motivuar njerëzit t'i shtojnë adhurimet ndaj Allahut, si: namazi, lëmosha, përmendja e Allahut, leximi i Kuranit dhe veprat e tjera të mira, si dhe për t'u larguar nga gjynahet dhe veprat e këqija.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/10107>

